



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:134119

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06525080

AC-I.-24-0559

Në ankesën e :

A H nga Obiliqi i vjetër, i përfaqësuar nga avokati B B nga Prishtina.

Paditësi

Kundër:

NSH "Auto Prishtina" e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr. "Dritan Hoxha"- Lakrishte, nr. 55, Prishtinë.

E paditura/Ankuesja

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr.sc Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV.-22-0176 të datës 14 qershor 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 29 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV.-22 - 0176 të datës 14 qershor 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Reethanat faktike dhe procedurale:

Më datë 29 prill 2015 paditësi kishte parashtruar padi në DHPGJS kundër NSH "Auto Prishtina", me të cilën ka kërkuar pagesën e pagave të papaguara për periudhën tetor 2003 deri në qershor 2014 në shumën prej 47.450.00 euro me interesin ligjor

prej 3.5 % për çdo vit. Paditësi thekson se ka qenë i punësuar te NSH-ja dhe se e paditura me shkresën e datës 11 nëntor 2014 i ka njoftuar për fillimin e procesit të likuidimit të NSH-së me datën 21 korrik 2014. Po ashtu, është njoftuar edhe për anulimin e të gjitha kontratave të punës të cilat deri atëherë kanë qenë në fuqi. Paditësi pretendon se në mes menaxhmentit dhe këshillit të punëtorëve ka pasur mosmarrëveshje, është dëmtuar me mos pagesë të pagës për periudhën kohore nga viti 2003 e deri në qershor 2014. Paditësi thekson se në vazhdimësi ka kërkuar kompensimin e pagave si nga menaxhmenti i NSH-së ashtu edhe nga pala e paditur dhe se vetëm i janë dhënë premtime për kompensimin e pagave dhe kontributeve pensionale, mirëpo pagesa nuk i është bërë. Paditësi i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë e tij si të bazuar, ta detyroj të paditurën që t'ia kompensojë shumën prej 47.450.00 euro me kamatën ligjore vjetore prej 3.5%.

Më datë 02 nëntor 2017, AKP kishte parashtruar përgjigje ndaj kësaj padie. AKP thekson se NSH ka hyrë në procedurën e likuidimit më datën 21 korrik 2014, dhe se pala paditëse pranë saj ka parashtruar kërkesë me pretendimin se nuk i janë kompensuar pagat në shumën prej 47.450.00 euro për periudhën nga data 30 shtator 2003 e deri në qershor të vitit 2014. AKP ka theksuar se me Vendimin PRN126-0152 të datës 31 mars 2015, ishte refuzuar kërkesa e parashtruar nga paditësi, për shkak të parashkrimit konform nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. AKP i kishte propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar dhe ta vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-033.

Më datë 27 janar 2021, Shkalla e parë e DHPGJS-së kishte marrë Aktgjykimin C-IV.-15-0680, me të cilin kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shkalla e I-rë arsyeton se ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar se pala paditëse ka qenë në marrëdhënie pune në NSH, gjë që vërtetohet nga kontrata e punës e cila gjendet në shkresat e lëndës. NSH ka hyrë në procedurë të likuidimit më datë 21 korrik 2014, ku Autoriteti i Likuidimit duke u bazuar në nenin 8 të Shtojcës së Ligjit nr. 041/L-034 për AKP-në, në të cilin parashihet se, *mesnatën e ditës së vendimit për likuidim, ndërpriten të gjitha kontratat e punës që kanë qenë në fuqi deri atëherë ndërmjet ndërmarrjes dhe punonjësve të saj, nëse të tilla ekzistojnë*. Bazuar në këtë, NSH i ka ndërprerë të gjitha kontratat ekzistuese. Shkalla e I-rë thekson se në rastin konkret borxhi i

pretenduar nga pala paditëse i përket periudhës nga tetori i vitit 2003 e deri në qershor të vitit 2014, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 376 paragrafi 1 i LMD-së (1978), ku parashihet afati 3 vjeçar i parashkrimit, rezulton se kërkesa e palës paditëse është parashkruar.

Më 15 prill 2021 paditësi kishte parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi. Paditësi thekson se neni 367 i LMD-së nga viti 1978 ka të bëjë me shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve, nuk ka lidhje me rastin e thirrjes në nenin 608 të LPB. Është e çuditshme se ku mund të justifikohet mos pagesa e pagave në vitin 2021. Me faktin se NSH-ja iu ka paguar të gjithë punëtorëve në marrëdhënie pune akontacion për çdo muaj nga 85 euro, vërtetohet se NSH u ka ngel borxh punëtorëve për pjesën tjetër të pagesës. Paditësi thekson se kontrata e punës ka qenë në fuqi nga data 03 tetor 2003 deri më datë 23 prill 2015. Sipas paditësit, gjykata në aktgjykim nuk i ka përmendur fare pretendimet e paditësit përmes ankesës së tij kundër vendimit PRN126-0153 të datës 29 prill 2015 me të cilën Autoriteti i Likuidimit nuk ka dhënë fare përgjigje. Paditësi thekson se në ankesën e datës 12 maj 2015, paditësi e ka kundërshtuar vendimin për dëmshpërblim, për shkak të ndërprerjes së punës, me të cilin iu kishin pranuar 242.19 euro sipas vendimit të datës 29 prill 2015, të cilin paditësi thekson se e ka kundërshtuar më 12 maj 2015 dhe njëkohësisht e kishte kërkuar ndryshimin e bazës së marr për llogaritjen e pagave prej 85.00 euro duke pohuar një të vërtetë se paditësi gjatë periudhës për të cilën kërkon paga nuk kishte marrë pagë mujore 85.00 euro, por ky ishte akontacion për paga. Kurse paga mujore sipas paditësit, në kontratën e punës ishte 450.00 euro në muaj. Paditësi thekson se gjykata ka marrë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore, por edhe pa kërkuar fare përgjigje në padi. Paditësi thekson se gjykata në arsyetimin e aktgjykimit nuk e ka përmendur asnjë dispozitë ligjore e cila ia ndalon paditësit që të kërkojë të drejtën e tij në pagesën e pagave të pa paguara. Paditësi pretendon se aktgjykim i Shkallës së I-rë është krejtësisht i pa bazuar në fakte dhe prova, pasi që i njëjti e përsërit tekstin nga padia e paditësit. Paditësi thekson se ai si një nga punonjësit e NSH-së është bashkëpjesëmarrës në kontestin kundër B S i cili sipas paditësit e kishte uzurpuar objektin e NSH-së dhe ky kontest ka shkuar deri në Gjykatën Kushtetuese. Paditësi pretendon se për vendimin e Gjykatës Kushtetuese nuk është informuar as ai dhe as të punësuarit e tjerë në NSH dhe pjesa e përfitimit të punëtorëve nga qiraja për objekt apo kompensim tjetër të mundshëm nuk kanë përfituar asgjë. Procesi i likuidimit ka filluar më 21 korrik 2014 dhe me këtë rast

janë anuluar të gjitha kontratat që kanë qenë në fuqi. Kjo dëshmon se ndërprerja e marrëdhënies së punës ka ardhur si rezultat i likuidimit nga na a e AKP-së. Padiësi pretendon se ai me një deklaratë personale ia kishte bërë me dije AKP-së se NSH i kishte mbetur borxh pagat e pa paguara në shumën prej 47.450,00 euro ndërsa e paditura nuk ka dhënë asnjë përgjigje, por as që është përmendur ky fakt në vendimin e kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së. Edhe gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse ka vendosur pa mbajtur seancë dëgjimore dhe pa e dërguar padinë për përgjigje. Bazuar në nenin 401 të LPK-së, "seanca përgatitore është e detyrueshme, përveç në rastet në të cilat gjykata, pasi që të ketë arritur përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk ka falte kontestuese, apo kur nga shkak i jo ndërlikueshmërisë së kontestit, vjen në përfundim se nuk ka nevojë të konvokohet seanca përgatitore.....". Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit nuk ka përmendur asnjë dispozitë ligjore e cila ia ndalon padiësit që të kërkoj të drejtën e tij për paga te pa paguara, andaj ankuesi konsideron se aktgjykimi i ankimuar është e pa bazuar në fakte e prova konkrete. Ai propozon që të anulohet aktgjykimi i Shkallës së I-rë dhe lënda të kthehet në rigjykim në Shkallë të I-rë të DHPGJS-së.

Më 31 mars 2022, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, këtë ankesë e ka dërguar tek AKP për përgjigje. Në përgjigjen e saj të datës 15 prill 2022 AKP i kundërshton pretendimet ankimore të padiësit si të pa bazuar dhe propozon që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj. AKP thekson se ajo argumentet e saja i ka dhënë në mbrojtje ndaj padisë dhe asgjë nuk dëshiron që të ri përsëris nga argumentet që i ka dhënë në këtë mbrojtje.

Me datë 24 qershor 2022, Kolegji i Apelit me Aktvendimin A-C-I-21-0239-A0001, ankesën e padiësit e aprovon si të bazuar e anulon Aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën e kthen në rigjykim tek gjyqtari përkatës. Kolegji i Apelit ka arsyetuar Kolegji i Apelit konsideron se padiësi ka të drejtë kur thekson se kërkesa e tij nuk është parashkruar, pasi që kjo kërkesë mund të jetë e parashkruar pjesërisht por jo në tërësi, andaj ishte i gabuar vlerësimi për parashkrimin e kërkesës, pasi që kjo kërkesë konsiston për periudhën 2003 deri më 2014 ndërsa kërkesa ishte parashtruar në vitin 2015. Padiësi thekson se gjykata ka marrë Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore, por edhe pa kërkuar fare përgjigje në padi. Padiësi thekson se gjykata në arsyetimin e Aktgjykimit nuk e ka përmendur asnjë dispozitë

ligjore e cila ia ndalon paditësit që të kërkoj të drejtën e tij në pagesën e pagave të pa paguara. Këto pretendime janë të bazuara, për faktin se kjo është një kërkesë ligjore dhe pala ka të drejtë të realizoj kërkesën e tij duke u ballafaquar më argumente shtesë që do i paraqes në një seancë dëgjimore, e që në këtë rast konkret është privuar nga kjo e drejtë. Paditësi në ankesë thekson se ai dhe punëtorët tjerë të NSH-së ishin bashkëpjesëmarrës në kontestin kundër B S, i cili sipas paditësit e kishte uzurpuar objektin e NSH-së dhe ky kontest ka shkuar deri në Gjykatën Kushtetuese. Paditësi i propozon gjykatës që nga e paditura të kërkoj informacione në lidhje me kontestin e përmendur. Edhe ky rast mund të jetë i rëndësishëm për këtë rast konkret dhe kjo dëshmon për domosdoshmërinë e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor për ti ballafaquar argumentet dhe provat me palën kundërshtare drejtpërdrejt. Kolegji i Apelit kishte kërkuar nga paditësi që të dorëzoj në gjykatë dëshmi për dorëzimin e kërkesës tek Autoriteti i Likuidimit i AKP-së dhe Vendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRN126-0152 të datës 31 mars 2015. Qëllimi i këtij urdhri ishte që të vërtetohet se a është kërkesa e njëjtë ajo që është parashtruar tek Autoriteti i Likuidimit i AKP-së dhe ajo që është kërkuar drejtpërdrejt në gjykatë, pasi që nuk ka asnjë lëndë tjetër në pritje lidhur me këtë paditë në DHPGJS. Paditësi është përgjigjur në urdhër, por ka ofruar një mori dëshmi tjera, por nuk e ka ofruar vendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së. Kolegji i Apelit konsideron se kjo neglizhencë e paditësit është si rezultat i mos përfaqësimit adekuat, pasi që ai nuk përfaqësohet nga një avokat i licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim ajo regjistrohet me numrin e ri, C-IV-22-0176.

Me datë 22 maj 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS e mbanë një seancë dëgjimore lidhur me padinë. Në bazë të procesverbalit vërehet se të dy palët mbeten pranë pretendimeve të tyre të cekura gjatë procedurës me shkrim.

Me datë 29 maj 2024, paditësi e dorëzon në DHPGJS fjalën përfundimtare me shkrim. Në fjalën përfundimtare paditësi pohon se në procedurën e deri tanishme janë sjellë të gjitha provat e disponueshme e me të cilat vërtetohet se ka të drejtë në paga të pa paguara për periudhën e cekur në padinë fjalën përfundimtare ka kërkuar që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit dhe të obligohet AKP-ja që paditësit ti paguaj shumën prej

47.450,00 euro, interesin ligjor prej 10 % në shumë prej 4,745.00 euro, si dhe shpenzimet e përfaqësimit gjithsej prej 540 euro.

Me datë 14 qershor 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS me pikën **1** të dispozitivit të Aktgjykimit C-IV-22-0176 e aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit PRN126-0152 të datës 31 mars 2015. Me pikën **2** të dispozitivit të Aktgjykimit e detyron të paditurën që më emër të pagave të pa paguara për periudhën 11 shtator 2011 e deri 1 qershor 2014 ti paguaj paditësit shumën prej 11,923.30 euro (llogaritur shumën bruto prej 365.00 euro për cdo muaj), me interes ligjor prej 10 %, në shumë prej 1, 155.50 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS me pikën **3** të dispozitivit të Aktgjykimit e refuzon si të pa bazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë në shumë prej 35,526.70 euro, për periudhën kohore nga muaji tetor 2003 e deri më 11 shtator 2011, ndërsa me pikën **4** detyrohet e paditura ti paguaj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 388.00 euro.

Shkalla e I-rë e DHPGJS ka arsyetuar ashtu si është përcaktuar në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën e përgjithshme prej 11,923.30 euro, më kamatë ligjore prej 10% në shumën prej 1,192.30 euro, bazuar në dispozitën e nenit 262 paragrafi 1 të LMD-së e cila dispozitë në mënyrë shprehimore përcakton se "Kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij", për periudhën kohore 11 shtator 2011 e deri me datën 1 janar 2013, ndërsa bazuar në dispozitën e nenit 245 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës për periudhën kohore 1 janar 2013 deri me datën 21 korrik 2014. Aprovimi i kërkesës së specifikuar si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi gjykata e ka bazuar paraprakisht në listën e punëtorëve të datës 12 shtator 2014 nga e cila rezulton se pagat e papaguara janë në shumën prej 365,00 euro në muaj pas që shuma prej 85.00 euro është marrë në formë të akontacionit, ndërkohë që sipas kontratës së datës 3 tetor 2003 që mbanë numër 320 është përcaktuar paga bruto në shumë prej 450.00 euro për punëtorin NSH Auto Prishtina A H nga Obiliqi i Vjetër, që do të thotë se e paditura është e detyruar që shumën prej 365.00 euro bruto në muaj ti paguaj paditësit për pagat e papaguara, te cilat pas llogaritjes për periudhën kohore prej 32 muaj e njëzetë ditë vlerësohet se shuma e përgjithshme për pagat

e papaguara është në vlerë prej 11.923.30 euro. Gjykata ka vendosur ashtu si është përcaktuar në pikën tre të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar për shumën e përgjithshme prej 35,526.70 euro për periudhën kohore prej muajit tetor 2003 deri me datën 11 shtator 2011 pasi që kërkesa e paditësit për këtë periudhë kohore është e parashkruar duke iu referuar dispozitës së nenit 376 të LMD-së me të cilën dispozitë në mënyrë shprehimore është e përcaktuar se "kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin". Në rastin konkret borxhi i pretenduar nga pala paditëse i përket periudhës nga tetori i vitit 2003 e deri me datën 21 korrik 2014 kur edhe Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka marrë vendimin e saj për anulimin e të gjitha kontratave të punës për të punësuarit në NSH Auto Prishtina, andaj në kuptim të dispozitës ligjore të cituar rezulton se kërkesa e palës paditëse për këtë periudhë kohore është e parashkruar. Llogaritja e kamatës ligjore prej 10% për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 1.192.30 euro është bazuar në dispozitën e nenit 37 paragrafi 3 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit që evidentohet me shenjë Nr.04/L-034 e cila dispozitë në mënyrë shprehimore përcakton se "Të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore." andaj edhe gjykata ka vendosur ashtu si është përcaktuar në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me datë 8 korrik 2024, AKP-ja përmes postës e ka dërguar në DHOGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-22-0176 të datës 14 qershor 2024, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të refuzohet ankesa e paditësit, të paraqitur ndaj vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se në bazë të nenit 54 të LDHP-së, gjykata duhet ta mbështetë Aktgjykimin e saj në bazë të analizimit të provave, parashtrësive verbale me shkrim që paraqiten gjatë procedurave gjyqësore. Ndërsa në bazë të nenit 9 par.4 nën par 2 i LDHP, Aktgjykimi përmban një prezantim të gjitha gjetjeve faktike me rendësi materiale për rastin apo lëndën që është objekt i atij Aktgjykimi. Tutje AKP-ja në ankesë pohon se bazuar në nenin 49.1.6.2 të Shtojcës së ligjit të AKP-së mund të jepet dëmshpërblimi vetëm atyre

punëtorëve që janë pushuar nga puna si pasojë apo në lidhje me një veprim të ndërmarrë nga AKP-ja. Tutje AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën e paditësit për paga të pa paguara pasi që ky rezultat të mos ishte aktiv në momentin kur filloi likuidimi i NSH-së. Duke injoruar argumentet e ngritura në mbrojtje në ankesë, Aktgjykimi nuk përmbush detyrimet e shprehura në nenin 54 të LDHP-së. Tutje AKP-ja pohon se DHPGJS duhet të lëshohet në shqyrtimin e çështjes kontestuese dhe ti merr parasysh argumentet e ngritura nga Autoriteti i Likuidimit.

Me datë 21 gusht 2024, paditësi e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe e mbështetë Aktgjykimin e ankimuar duke konsideruar së të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në këtë parashtresë paditësi pohon se nuk qëndron pohimi i AKP-së se paditësi nuk ishte aktiv në NSH në momentin kur filloi likuidimi i NSH-së. Ky pohim kundërshtohet me prova materiale të dorëzuara në shkresa të lëndës, kontratën e punës me kohë të pa caktuar, listën e punëtorëve aktiv të NSH-së e datës 12 qershor 2014 dhe Librezën e Punës. Këto dokumente flasin se paditësi ishte punonjës aktiv i NSH-së deri me 21 korrik 2014, kur filloi likuidimi i NSH "Auto Prishtina" paditësi pohon se e paditura ka tendencë të shtrembëroj provat dhe faktet me qëllim të zvarritjes së procedurës, gjë që nuk është në favor as të paditurës ngase paditësit duhet ti njihet e drejta në interes ligjor për gjitha këto vite të prolongimit të kësaj çështje juridike me fajin e të paditurës

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 11 shtator 2014 e ka dorëzuar një kërkesë për pagesën e pagave të pa paguara nga muaji tetor të vitit 2003 e deri me 1 qershor 2014 në shumë prej 47,450.00 euro, e cila kërkesë me vendimin PRN126-0152 të datës 31 mars 2015, është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me

arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësi me datë 29 prill 2015 e ka kundërshtuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit me ankesën e dorëzuar në DHPGJS duke mos u pajtuar me konstatimin se kërkesa është parashkruar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS për të njëjtën bazë ligjore e kishte refuzuar ankesën e paditësit me Aktgjykimin C-IV-15- 0680 të datës 27 janar 2021.

Në bazë të ankesës së paditësit, Kolegji i Apelit me Aktvendimin A-C-I-21-0239-A0001 e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar e anulon Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë, dhe lëndën e kthen në rigjykim, duke mos u pajtuar me konstatimin e Autoritetit të Likuidimit dhe të Shkallës së I-rë se kërkesa për paga tërësisht është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me parashtresat e tij gjatë procedurës me shkrim të dorëzuara në shkallën I-rë, ka sjellë këto prova: një konfirmim për SHA Auto Prishtina, një njoftim të Autoritetit të Likuidimit, të datës 23 prill 2015 një parashtresë të AKM-së të datës 19 gusht 2004, një deklaratë të paditësit, një kontratë punë të datës 3 tetor 2003, njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 11 nëntor 2014 , një letër konfirmim për përvojën e punës në NSH, dhe listën e punëtorëve aktiv që nuk kanë marrë paga në NSH nr.4 datë 12 qershor 2014, në të cilën listë paditësi ka numër rendor 4.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë e DHPGJS pasi lënda është kthyer në rigjykim e ka mbajtur edhe një seancë dëgjimore mbi padinë me datë 22 maj 2024. Në bazë të procesverbalit të seancës vërehet se dy palët i kanë përsërit pretendimet për objektin kontestues.

Duke u bazuar në provat materiale të cilat paditësi i ka sjellë në Shkallën e I-rë të DHPGJS gjatë procedurës me shkrim, Kolegji i Apelit konstaton se Shkalla e I-rë e DHPGJS me të drejtë pjesërisht e ka provuar ankesën e paditësit, duke ia njohur paditësit të drejtën e kompensimit të pagave të papaguara për periudhën që nuk është parashkruar, gjegjësisht për periudhën nga 11 shtator 2011 e deri me 1

qershor 2014, në shumë prej 11,923.30 euro. Shkalla e I-rë e DHPGJS këtë shumë e ka aprovuar duke u bazuar në listën e punëtorëve për paga të pa paguara të datës 12 shtator 2014, sipas të cilës rezulton se paga mujore e mbetur borxh ishte 365.00 euro ndërsa shuma tjetër prej 85.00 euro është marrë në formë të akontacionit. Shkalla e I-rë e DHPGJS shumën e cekur në emër të pagave të pa paguara e ka aprovuar për 32 muaj, për periudhën që nuk konsiderohet e parashkruar, marrë për bazë kërkesën e paditësit të parashkruar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 11 shtator 2014. Me këto prova vërtetohet se paditësi ishte punëtor i NSH-së deri në momentin e likuidimit të NSH-së, dhe se ai ka ofruar shërbime pune për NSH-në.

Kolegji i Apelit e mbështetë Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS edhe sa i përket interesit ligjor. Paditësi bazuar në nenin 37 par.3 të Shtojcës së ligjit të AKP-së ai ka të drejtë ti njihet edhe e drejta në interes ligjor prej 10% që në këtë rast shkalla e I-rë me të drejtë e ka aprovuar shumën prej 1,155.80 euro, prandaj sikur shuma lidhur me borxhin kryesor, ashtu edhe shuma lidhur me interesin ligjor, por edhe shuma e aprovuar në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumë prej 388.00 euro, duhet të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në Procedurën e Likuidimit.

Prandaj nga arsyet e cekuar rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar nuk mund të ndryshohet, andaj ankesa e AKP-së refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga sa u tha më lart në bazë të nenit 9.8 të LDHP-së , është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datën 24 korrik 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit me datë 29 nëntor 2024

Mr.sc Sahit Sylejmani , Gjyqtar kryesues _____